

“KASTRIOTI&PETROL” SHPK

K624215010

Pranë rrethrotullimit, Plepa Durrës

VENDIM Nr. 3

i

Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

(Marrë në zbatim të neneve 168, 169 dhe 177 e në vijim

të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”).

Sot, në datën 05 Qershor 2018, në selinë e shoqërisë tregtare “KASTRIOTI&PETROL” SHPK me adresë: “pranë rrethrotullimit, Plepa - Durrës”, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të kësaj shoqërie me rend dite:

- 1) Rritjen e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “KASTRIOTI&PETROL” SHPK me vlerë 56 845 000 LEKE me rezervat e disponueshme të akumuluar, pasqyruar në bilancin e vitit 2017 dhe në bilancin e reformuar me datë 07 Qershor 2018, në zbatim të nenit 177 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 2) Caktimin e Audituesit Ligjor për të përgatitur raportin për zmadhimin e kapitalit të regjistruar për vlerën 56 845 000 LEKE
- 3) Të tjera

Në mbledhjen e Asamblesë morën pjesë ortakët që zotërojnë 100 % të kapitalit, si vijon:

- i. Shefit KASTRATI 50%
- ii. Mujo NERGUTI 50%

Asambleja konstatoi se:

Në bilancin kontabël të vitit 2017 janë pasqyruar rezerva të disponueshme me vlerë 56 845 015 LEKE, të akumuluar nga shpërndarja e fitimeve të viteve të mëparshme, miratuar me vendimet e Asambleve të viteve përkatëse si vijon:

Viti i krijimit	Vendimi i Asamblesë		Vlera e fitimit, kaluar në Rezerva
	Nr.	Datë	
Nga fitimi i vitit 2017	2	28.05.2018	20,779,982
Nga fitimi i vitit 2016	2	20.06.2017	18,590,699
Nga fitimi i vitit 2015	2	23.06.2016	14,986,486
Nga fitimi i vitit 2014	2	24.06.2015	2,486,861
Nga fitimi i vitit 2013			987
Totali			56,845,015
Rezerva të kapitalizuara			(56,845,000)
Rrumbullakosje kuote (pjesë)			15

“KASTRIOTI&PETROL” SHPK

K624215010

Pranë rrethrotullimit, Plepa Durrës

Në përfundim Asambleja e Përgjithshme,

V E N D O S I:

1. Të rrisi kapitalin e regjistruar të shoqërisë “KASTRIOTI & PETROL” SHPK me rezervat e disponueshme të pasqyruara në pasqyrat financiare 2017 dhe bilancin e reformuar për vlerën 56 845 000 LEKE.

Viti i krijimit	Vlera e fitimit, kaluar në Rezerva	Rezerva të kapitalizuara
Nga fitimi i vitit 2017	20,779,982	20,779,982
Nga fitimi i vitit 2016	18,590,699	18,590,699
Nga fitimi i vitit 2015	14,986,486	14,986,486
Nga fitimi i vitit 2014	2,486,861	2,486,861
Nga fitimi i vitit 2013	987	972
Totali	56,845,015	56,845,000

2. Pas rritjes, kapitali i regjistruar i shoqërisë nga 19 544 000 bëhet 76 389 000 LEKE.
3. Rritja do të shlyhet me rezervat e disponueshme, pasqyruar në pasqyrat financiare 2017 dhe bilancin e reformuar me datë 07 Qershor 2018.
4. Audituesi ligjor që do të përgatisti raportin për zmadhimin e kapitalit është Zj. Marije DUSHI, me liçence profesionale nr. 51, datë 10.02.2000 auditues - partner dhe ortakë e shoqërisë “FICADEX ALBANIA” SHPK.
5. Regjistrimi në QKR të bëhet brenda afatit ligjor.
6. Për kryerjen e veprimeve përkatëse në QKR Autorizohet Z.Indrit Qehaja.

Ortakët e shoqërisë “KASTRIOTI & PETROL” SHPK

Shefit KASTRATI

Mujo NERGUTI



"KASTRIOTI&PETROL" SHPK

K624215010

Pranë rrethrotullimit, Plepa Durrës

VENDIM Nr. 4

i

Asamblesë së Përgjithshme

Sot, në datën 14 Qershor 2018, në selinë e shoqërisë tregtare "KASTRIOTI&PETROL" SHPK me adresë: "Pranë rrethrotullimit, Plepa Durrës", u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të kësaj shoqërie me rend dite:

1. Miratimin e Raportit të Audituesit Ligjor, i përgatitur për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "KASTRIOTI&PETROL" SHPK me kalimin / (kapitalizimin) e rezervave të disponueshme
2. Të tjera

Në mbledhjen e Asamblesë morën pjesë ortakët që zotërojnë 100 % të kapitalit, si vijon:

- i. Shefit KASTRATI 50%
- ii. Mujo NERGUTI 50%

Në përfundim të mbledhjes Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

- 1) Miratimin e raportit të paraqitur nga zj. Marije DUSHI, Auditues Ligjor - ortake e shoqërisë "FICADEX ALBANIA" SHPK "për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kalimit/ (kapitalizimit) të rezervave të disponueshme", në zbatim të vendimit të ortakut nr. 3 datë 05 Qershor 2018
- 2) Kapitali i regjistruar i shoqërisë zmadhohet me vlerën 56,845,000 LEKE. Pas zmadhimit, kapitali i regjistruar nga 19 544 000 LEKE bëhet 76,389,000 LEKE. Kapitali zotërohet 50 % nga Ortaku Shefit KASTRATI dhe 50% nga ortaku Mujo NERGUTI.
- 3) Shlyerja 100% e vlerës së rritjes së kapitalit të regjistruar është bërë me kalimin e rezervave të disponueshme sipas Bilancit të reformuar me datë 07 Qershor 2018.
- 4) Ky vendim të depozitohet në Q.K.B dhe në departamentin e kontabilitetit.
- 5) Për të kryer veprimet përkatëse në QKR lidhur me depozitim të këtij vendimi, autorizohet Z. Indrit Qehaja

Ortakët e shoqërisë "KASTRIOTI & PETROL" SHPK

Shefit KASTRATI

Mujo NERGUTI

